



# Republika e Kosovës

*Republika Kosova-Republic of Kosovo*

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice*

Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Korrektional Service  
Drejtoria Qendrore-Prishtinë

## DOSJA E TENDERIT

për  
qiradhënie përmes

### **Ofertimit Publik**

*Sipas Nenit 27 të Ligjit nr. 04/L-042, Ligji i Prokurimit Publik të Kosovës*

Data e përgatitjes së Dosjes së Tenderit:

29.07.2020

**Titulli: Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)**

Numri referues i qeradhënies: **SHKK-20-001-DHQ**

#### **KJO DOSJE E TENDERIT PËRBËHET NGA TRI PJESË:**

**Pjesa A: Procedurat e Tenderimit;**

**Pjesa B: Draft Kontratën; dhe**

**Pjesa C: Formularin e Tenderit**

**Kjo Dosje e Tenderit është përgatitur në gjuhën Shqipe dhe sipas nevoje edhe në gjuhët tjera**

**Në rast se ka dallime në mes të versioneve gjuhësore, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotëroj.**

Numri: SHKK-20-001-DHQ, Titulli: "Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)"

**LËNDA: FTESË PËR TENDER për: “Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)”**

Ju faleminderit për interesimin e juaj në lidhje me pjesëmarrjen në aktivitetin e shitjes të lartcekur.

Sipas kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkangjitur dokumentet, të cilat përbëjnë Dosjen e Tenderit.

Nga ju pritet që të ekzaminoni me kujdes të gjitha pjesët, nenet dhe anekset e kësaj dosjeje të tenderit dhe të pajtoheni me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

Ne, si Autoritet Kontraktues nuk pranojmë asnjë ndryshim.

Në rast të dështimit të dorëzimit të tenderin tek autoriteti kontraktues brenda afatit të caktuar në Dosjen e Tenderit, dhe/apo nuk është pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, do të refuzohet dhe do të konsiderohet si “*tender i papërgjegjshëm*”

Të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe me dorëzimin e tenderit duhet të barten nga tenderuesi, ndërsa autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura

Kjo procedure e tenderimit është e rregulluar me Ligjin e Prokurimit Publik (nr. i Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës i datës 29 Gusht 2011) dhe rregullat e nxjerra ne përputhshmëri me të.

LPP dhe Rregullat të cilat qeverisin shitjen mund të shkarkohen nga web-faqja e Komisionit Rregullativ të Prokurim Publik (KRPP): [www.krpp.rks-gov.net](http://www.krpp.rks-gov.net)

Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e specifikuar në Pjesën A “Procedurat e Tenderimit”, para afatit kohorë 17/08/2020 në ora 10:00h

Me dorëzimin e tenderit, tenderuesi pranon plotësisht dhe pa rezerva kushtet që qeverisin këtë kontratë të propozuar si baza e vetme për këtë procedurë të tenderimit.

Ne mirëpresim tenderin tuaj.

Nëse vendosni të mos e dorëzoni tenderin, do të ishim mirënjohës nëse do të na lajmëronit me shkrim, duke cekur arsyet e vendimit të juaj.

Sinqerisht,  
Emri dhe Mbiemri :

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

PËRMBAJTJA E TABELËS

PJESA A:	<i>PROCEDURAT E TENDERIMIT</i> .....	4
SEKSIONI I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT .....		4
TË PËRGJITHSHME .....		4
KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOHEN NGA OPERATORËT EKONOMIK .....		4
PËRMBAJTJA E DOSJES SË TENDERIT .....		7
PËRGATITJA E TENDERIT .....		8
DORËZIMI DHE HAPJA E TENDERËVE .....		9
VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE .....		9
DHËNIA E KONTRATËS .....		10
ANKESAT .....		10
SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD).....		10
ANEKS 1. PËRSHKRIMI I ASETËVE .....		13
ANEKSI 2 DEKLARATA NËN BETIM.....		13
ANEKSI 3 SIGURIA E TENDERIT .....		17
ANEKSI 4 KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË.....		18
PJESA B: <i>DRAFT KONTRATA &amp; KUSHTET E ËRGJITHSHME</i> .....		19
PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA.....		19
PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME.....		21
PJESA III E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR.....		23
<i>PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT</i> .....		24
SEKSIONI I. FORMULARI I TENDERIT .....		24
SEKSIONI II. LISTA E ASETËVE DHE PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE .....		25

**PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT**

**SEKSIONI I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT**

**Të Përgjithshme**

**1. Fushëveprimi i tenderit**

1.1 Autoriteti Kontraktues i **cekur në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT)**, lëshon e këtë Dosje të Tenderit për qeradhënie të asetëve të përshkruara në Aneksin 1, Përshkrimi i Asetëve. Çdo kontratë që rezulton do të nënshtrohet kushteve të detajuara në Pjesën B, Kontrata.

1.2 Kufizimet në blerje- shitje për zyrtarët publik – Zyrtarët publik nuk do të lejohen të blejnë më shumë se një atrikull të ngjashëm. Zyrtarët publik mund të tenderojnë për më shumë se një artikull të ngjashëm, por nëse ata vlerësohen si ofertues më të mirë në më shumë se një artikull të tillë, ata do të detyrohen të përcaktojnë artikullin e preferuar dhe do të marrin kontratën vetëm për atë artikull.

1.3 Titulli i kontratës dhe numri referues i këtij aktiviteti të shitjes janë të **shënuara në FDT**.

1.4 Informatat për publikimin e Njoftimit për Shitjes **është dhënë në FDT**.

1.5 Tenderët duhet të dorëzohen në adresën e autoritetit kontraktues të **shënuar në FDT**.

Përgjatë kësaj Dosje të Tenderit:

a) shprehja "me shkrim" kuptohet komunikimi në formë të shkruar (p.sh. me e- mail, faks, teleks) me dëshmi të pranimit;

b) nëse konteksti kërkon "njëjës" gjithashtu nënkupton "shumës" dhe anasjelltas;

c) "ditë" nënkupton ditën kalendarike;

d) ju jeni të referuar si "operator ekonomik", "kandidat" apo "tenderues" dhe

e) lëshuesi i kësaj dosje të tenderit referohet si "autoritet kontraktues".

**2. Qëllimi i Kontratës**

2.1 Qëllimi i kontratës **është i shënuar në FDT**.

2.2 Numri i pjesëve (loteve) **është i shënuar në FDT**.

2.3 Nëse kontrata është e ndare në pjesë (lote), secila pjesë mund të shpijë në dhënie e një kontrate të veçantë. Sasitë e dhëna për pjesët e ndryshme do të jenë të pandashme. Tenderuesi duhet të ofrojë tërësinë e sasisë ose të sasive të shënuara për secilën pjesë. Nëse tenderuesit i janë dhënë kontratat për më shumë se një pjesë, një kontratë e vetme mund të bëhet, duke i mbuluar të gjitha ato pjesë.

**3. Përshtatshmëria e operatorëve ekonomik**

**KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOHEN NGA OPERATORËT EKONOMIK**

Operatorët ekonomik duhet t'i plotësojnë të gjitha kërkesat në vijim. Çdo mos përmbushje e ndonjëres nga kërkesat do të eliminojë tenderin e tyre nga konkurrimi.

**Kërkesat e përshtatshmërisë**

**3.1 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij/saj:**

- a. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose
- b. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të këtyre të fundit.

**3.2 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të fundit:**

- a. është shpallur fajtorë nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP-se sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
- b. është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rende profesionale;
- c. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato; ose
- d. është shpallur fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente;
- e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
- f. është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër.

**3.3 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operator ekonomik:**

- a. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë: (i) të falimentimit, (ii) të pranimit të urdhrin për likuidim ose përmbyllje të aktiviteteve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër;
- b. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
- c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafte që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
- d. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në nën-paragrafët a, b ose c të këtij paragrafi, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;

- e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga ose për një operatori të tillë ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjeshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij;
- f. aktualisht është lëndë e një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon ose redukton pagesat nga ose për operatorët e tillë ekonomik nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
- g. gjatë tri (3) viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër;
- h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar te jete jo i rëndësishëm në Kosovë;
- i. është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;
- j. ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës ose OSHP-ja;
- k. ka një vend të ushtrimit të veprimtarisë afariste në Kosovë mirëpo nuk posedon një certifikatë aktuale dhe të vlefshme të lëshuar nga autoriteti publik përgjegjës për regjistrimin e shoqërive tregtare në Kosovë; ose
- l. nuk është shpallu fajtor me një vendim të plotfuqishëm të miratuar në përputhshmëri me Nenin 99.2 të LPP-se.

**Periudhat kohore të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të shitjes.**

3.4 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik ka të drejtë pjesëmarrjeje në procedurën e prokurimit, operatori ekonomik duhet të dorëzojë dëshmitë e dokumentuara të shënuara në FDT.

#### 4. Kërkesat minimale kualifikuese

4.1 Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat minimale kualifikuese të shënuara në FDT.

4.2 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale të kualifikimit për të marr pjesë në procedurën e shitjes, operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuuese të shënuara në FDT.

#### 5. Sigurimi i tenderit

5.1 Në qoftë se shënohet në FDT tenderuesi duhet të dorëzoj, si pjesë të tenderit të ti, një Sigurim të tenderit.

5.2 Siguria e tenderit duhet të jetë në shumën dhe për një periudhe valide siç është e shënuar në FDT, dhe mund të dorëzohet në një nga format e shënuara si më poshtë:

- a) me para të gatshme apo në ekuivalentin e parave të gatshme apo transfere bankare në ç`rast siguria e tenderit duhet të depozitohet në Bankën siç është e shënuar në FDT;
- b) çeku të vërtetuar nga një bankë e klasit të parë;
- c) letër krediti, të hapur dhe të konfirmuar nga një bankë e klasit të parë;
- d) bondi të sigurisë, i pagueshëm sipas kërkesës, të lëshuar nga një kompani e mirënjohur e sigurimit; apo
- e) garancie të pakushtëzuar bankare, të lëshuar nga një bankë e klasit të parë.

5.3 Nëse kërkohet Sigurimi i Tenderit dhe ndonjë tender nuk është shoqëruar me një të Sigurim të konsiderueshme të përgjegjshëm të Tenderit, tenderi do të refuzohet si tender i papërgjegjshëm.

5.4 Forma e sigurisë së tenderit është e specifikuar në Aneksin 3 të kësaj dosje të tenderit.

5.5 Autoriteti kontraktues do ta kthejë sigurinë e tenderit të depozituar brenda pesë (5) ditëve, pas ndodhjes së cilës do nga ngjarjet në vijim:

- a) skadimi i datës së vlefshmërisë së tenderit;
- b) dhënia dhe hyrja në fuqi e kontratës;
- c) anulimi ose përfundimi i aktivitetit të shitjes para dhënies ose hyrjes në fuqi të kontratës;
- d) Me tërheqjen e tenderit para afatit të fundit për dorëzimin e tenderit, përveç nëse është e deklaruar në DT që nuk është e lejuar një tërheqje e tillë.

5.6 Sigurimi i Tenderit mund të konfiskohet nëse:

- a) Autoriteti Kontraktues cakton që operatori Ekonomik ka dorëzuar informata të rrejshme apo mashtruese;
- b) Operatori Ekonomik e tërheq tenderin e tij pas datës së fundit për dorëzimin e tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit dhe
- c) Operatorit Ekonomik i është dhënë kontrata por refuzon ose dështon:
  - a. Të respektoj kushtet e kontratës; ose
  - b. Ta bëjë pagesën.

## Përmbajtja e Dosjes së Tenderit

### 6. Seksionet e Dosjes se Tenderit

6.1 Dosja e Tenderit përbëhet nga Pjesa A, B, dhe C, të cilat përfshijnë të gjitha Seksionet e prezantuara më poshtë, dhe duhet të lexohen së bashku me ndonjë Shtojce të lëshuar në përputhje me Informacion për Tenderuesit Neni 8.

#### PJESA A Procedurat e Tenderimit

- Seksioni I, Informata për Tenderuesit
- Seksioni II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT)
- Anekset

#### PJESA B Draft Kontrata

- Seksioni I, Draft Kontrata
- Seksioni II, Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)
- Seksioni III, Identifikimi Financiar

#### PJESA C Forma e Tenderit

- Neni I, Forma e Tenderit
- Neni II. Përshkrimi i Aseteve dhe çmimet

### 7. Sqarimet e Dosjes se Tenderit

7.1 Tenderuesit janë të lejuar të bëjnë një kërkesë me shkrim pran autoritetit kontraktues për informata shtesë ose sqaruese që ata mendojnë se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një tenderi të përgjegjshëm. Një kërkesë e tillë mund të bëhet me anë të përdorimit të formularit për kërkesë, shih Aneksin 4, dhe të dorëzohet tek autoriteti kontraktues në mënyrë elektronike, me shkrim ose faks. Autoriteti Kontraktues do të përgjigjet me shkrim çdo kërkesë për sqarim, me kusht që kërkesa e tillë është marrë jo më vonë se afati i **dhëne në FDT**. Autoriteti kontraktues do të dërgon kopjet e përgjigjes së tij tek të gjithë ata që kanë pranuar Dosjen e Tenderit duke përfshirë pyetjen por pa e identifikuar burimin e saj. Nëse Autoriteti kontraktues e sheh të domosdoshme që të ndryshoj Dosjen së Tenderit, si rezultat i sqarimit, atëherë duhet ta bëjë këtë sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 8 të Informatave për Tenderuesit.

**8. Ndryshimi i Dosjes se Tenderit** 8.1 Në çdo kohë para skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve, Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë Dosjen e Tenderit duke lëshuar një shtojcë.

8.2 Çdo shtojcë e lëshuar do të jetë pjesë e Dosjes së Tenderit dhe do t'i komunikohet me shkrim të gjithë operatorëve ekonomik që kanë marrë Dosjen e Tenderit.

8.3 Për t'iu dhënë tenderuesve të mundshëm kohe të mjaftueshme për të marrë parasysh shtesën në përgatitjen e ofertave të tyre, Autoriteti Kontraktues do të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e tenderëve në përputhje me Nenin 53 të LPP-së.

### **Përgatitja e TENDERIT**

**9. Gjuha e Tenderit** 9.1 Operatorët Ekonomik mund të përgatisin dhe të dorëzojnë tenderët e tyre dhe dokumentet e lidhura në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

**10. Inspektimi i aseteve** 10.1 Tenderuesit Potencial mund të inspektojnë paraprakisht asetet para përgatitjes së tenderit, në lokacion, kohë dhe datë të **shënuar në FDT**.

**11. Dokumentet që përbejnë Tenderin** 11.1 Tenderi duhet të përmbajë si në vijim:

- a) Formën e Dorëzimit të Tenderit duke përdorur formën e dhënë në Pjesën C të kësaj Dosje të Tenderit;
- b) Listën e aseteve dhe Përshkrimin e Çmimeve duke përdorur formën e dhënë në Pjesën C të kësaj Dosje të Tenderit, me çmime të plotësuara për të gjithë artikujt për të cilët ju tenderoni;
- c) Sigurimin e Tenderit, në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 5, *nëse aplikohet*;
- d) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 3, evidentimi i përshtatshmërisë së Tenderuesit;
- e) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 4, evidentimit i kërkesave minimale të kualifikimit, *nëse aplikohet*.

**12. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit** 12.1 Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€)

**13. Periudha e Vlefshmërisë së Tenderit** 13.1 Tenderët do të mbeten të vlefshme për atë kohë sa është e **shënuar në FDT**. Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të fillojë në datën e afatit të fundit të dorëzimit të tenderëve. Një tender që është valid për një kohë më të shkurtër, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues si jo e përgjegjshme.

13.2 Në rrethana të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së tenderëve të tyre. Kërkesat dhe përgjigjet duhet të bëhen me shkrim. Nëse Sigurimi i Tenderit kërkohet ajo do të zgjatet edhe për një periudhë përkatëse. Dështimi për t'iu përgjigjur kërkesës së bërë nga autoriteti kontraktues do të çojë në refuzimin e tenderit, pa konfiskim të Sigurimit të Tenderit të tij.

**14. Vulosja dhe Shënimi i Tenderit** 14.1 Tenderuesi duhet të përgatisë një origjinal të dokumenteve që përbejnë tenderin, siç përshkruhet në Informatat për Tenderuesit Neni 11 dhe në mënyrë të qartë të shënojë atë "**ORIGJINAL**." Përveç kësaj, Tenderuesi duhet të paraqesë kopje të tenderit, në numrin e **shënuar në FDT** dhe në mënyrë të qartë shënojë ato "**KOPJE**".

14.2 Tenderuesi duhet të vendosë tenderin origjinal dhe çdo kopje **në zarfe të veçanta** dhe në anën e përparme të secilit zarf do të::

- Shënon qartë si "**Origjinal**" apo "**Kopje**";



- Shënon Numrin Referues të Shitjes siç është e cekur në dosjen e tenderit dhe
- Shënon emrin dhe adresën e tenderuesit.

14.3 Zarfet pastaj duhet të mbyllet në një zarf të jashtëm që tregon vetëm:

- Adresën e vendit të dorëzimit të tenderëve;
  - Numrin Referues të Shitjes;
  - Paralajmërim, se zarfi nuk guxon të hapet para datës dhe kohës së hapjes së tenderit; dhe
1. Emrin dhe adresa e tenderuesit.

## Dorëzimi dhe Hapja e Tenderëve

### 15. Afati i fundit për dorëzim të tenderëve

15.1 Tenderët do të pranohen nga Autoriteti Kontraktues jo më vonë se data dhe koha e shënuar në FDT.

### 16. Tenderët e vonuar

16.1 Autoriteti Kontraktues nuk do marrë në konsideratë ndonjë tender që arrin pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Cilido tender i pranuar nga Autoriteti Kontraktues pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve do të deklarohet i vonshëm dhe do t'i kthehet tenderuesit i pa hapur.

### 17. Hapja e Tenderëve

17.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë hapjen e tenderit në publik në adresën, datën dhe kohën e cekur në FDT.

17.2 Çdo tenderues ka të drejtë të ketë përfaqësuesin prezent që të vrojtoj hapjen e tenderëve.

17.3 Të gjitha zarfet do të hapen një pas një, duke lexuar me zë: emrin dhe adresën e tenderuesit dhe Çmimin total të tenderit të specifikuar në formularin e dorëzimit të Tenderit. E gjithë kjo duhet të regjistrohen në procesverbalin e hapjes së tenderëve, i cili duhet të nënshkruhet nga Zyrtari i Prokurimit dhe nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e hapjes së tenderit. Kopjet e procesverbalit në fjalë, duhet tu dërgohen menjëherë të gjithë tenderuesve.

## Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

### 18. Ekzaminimi i tenderëve

18.1 Tenderët e pranuar **me kohë** do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen sipas kërkesave të përcaktuara në këtë Dosje të Tenderit.

18.2 Tenderi konsiderohet të jetë i **përgjegjshëm** kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të kësaj dosjeje të tenderit;
- b. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.

### 19. Sqarimi i Tenderëve

19.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga secili Tenderues individualisht sqarim mbi tenderin e tij/saj. Secili sqarim që dorëzohet nga tenderuesi në lidhje me tenderin e tij dhe që nuk është në përputhje me kërkesën nga autoriteti kontraktues nuk do të konsiderohet.

19.2 Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen vetëm me shkrim, por nuk guxon të kërkohet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit

## 20. Përgjegjshmëria e tenderëve

19.3 Autoriteti Kontraktues mund të korrigoj një gabim krejtësisht aritmetik në një tender. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të obligueshme për tenderuesin. Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla.

20.1 Nëse tenderi nuk është i përgjegjshëm do të refuzohet dhe nuk mund të bëhet i tillë që të jetë në pajtueshmëri më vonë duke e korrigjuar atë ose duke e tërhequr largimin ose kufizimin.

20.2 Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen dhe krahasohen sipas kriteve për dhënien e kontratës të përcaktuara në Dosjen e tenderit. Tenderuesi i cili ka dorëzuar tenderin e renditur më të lartë do t'i jepet kontrata, subjekt i ndonjë rezervimi në lidhje me dështimin për të arritur vlerësimin zyrtarë ose çmimin fillestarë dhe subjekt i kufizimit të jo më shumë se një artikulli të ngjashëm për një zyrtarë publik.

## Dhënia e Kontratës

## 21. Kriteret e Dhënies se Kontratës

21.1 Kontrata do të shpërblehet sipas kriteve për dhënien e kontratës siç është shënuar në FDT.

## Ankesat

## 22. Ankesat

22.1 Sipas nenit 109.1 të Ligjit për Prokurimin publik në Kosovë (Ligji Nr. 04/L-042), një ankesë mund të dorëzohet nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritet kontraktues në fjalë që pretendohet të ketë bërë shkelje të këtij ligji, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij.

22.2 Formulari standard i ankesës mund të shkarkohet nga ueb faqet e KRPP-së dhe OSHP-së: [www.krpp.rks-gov.net](http://www.krpp.rks-gov.net) ose [www.oshp.rks-gov.net](http://www.oshp.rks-gov.net).

22.3 Ankesa do të dorëzohet në origjinal Organit Shqyrtues të Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues.

22.4 Kurdo që ankesa ka të bëjë me vendimin përfundimtar të shpërblimit të kontratës apo të anulimit të aktivitetit të prokurimit ankesa duhet të dorëzohet vetëm brenda periudhës 10 (dhjetë) ditësh, pas datës së Njoftimit të dhënies së kontratës apo Njoftimit për anulim që i është dërguar tenderuesit

22.5 Të gjithë parashtuesit e ankesës duhet të paguajnë një pagesë për ankesë në vlerë prej **500 €** së bashku me paraqitjen e ankesës. Pagesa do të bëhet me para të gatshme apo të barasvlershme në llogarinë e krijuar nga OSHP.

22.6 Referohuni në LPP dhe Rregullat e Prokurimit për procedura të mëtutjeshme të ankesave.

## SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD)

**Numri: SHKK-20-001-DHQ, Titulli: "Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)"**

Të dhënat e mëposhtme do të plotësojnë, shtojnë, ose ndryshojnë dispozitat e Informatave për Tenderuesin. Kurdo që paraqitet ndonjë mospërputhje, këto dispozita do të mbizotërojnë mbi ato në Informata për Tenderuesit.

*[Udhëzimet për plotësimin e Fletës mbi të Dhënat e Tenderit janë shënuar me germa kursive për Nenet relevante të Informatave për Tenderuesit. Fshijini ato që nuk janë të nevojshme]*

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve
Përshkrimi i Nenet	Nr. i Nenet	
Fusha e tenderit	1.1	<p>Autoriteti Kontraktues (AK) është:</p> <p><b>Emri i AK:</b> Sherbimi Korrektues I Kosoves</p> <p><b>Adresa e AK:</b></p> <p><b>Qyteti:</b> Prishtinë</p> <p><b>Kodi Postar:</b> 10000</p> <p><b>Adresa Elektronike:</b> <a href="https://shkk.rks-gov.net/">https://shkk.rks-gov.net/</a></p> <p><b>Personi Kontaktues:</b> Gezim Mustafa</p> <p><b>E-mail:</b> <a href="mailto:gëzim.mustafaj@rks-gov.net">gëzim.mustafaj@rks-gov.net</a></p> <p><b>Telefoni:</b> 038 200 18 126</p>
	1.2	<p>Titulli dhe numri referues i aktivitetit të shitjes është:</p> <p><b><i>Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)</i></b></p>
	1.3	<p>Data e dorëzimit të Njoftimit të Shitjes në KRPP:</p> <p>Publikimi i Njoftimit të Shitjes (version i ngjeshur):</p>
	1.4	Tenderi duhet të dorëzohet në adresën e përmendur në 1.1
Qëllimi i Kontratës	2.1	<p>Qëllimi i kontratës është:</p> <p><b><i>Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)</i></b></p>
Ndarja në lote e kontratës	2.2	Kontrata nuk është e ndarë në pjesë.
Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	3.4	Një deklaratë me shkrim nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

Kërkesat minimale të kualifikimit	4.1	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Deklarata nën betim</b></li> <li>2. <b>Qertifikata e regjistrimit të biznesit;</b></li> <li>3. <b>Deklaratën se dëmet eventuale që mund tu shkaktohen pronës gjatë shfrytëzimit do ti bartë OE,</b></li> </ol>
Sigurimi i përmbushjes së tenderit	5.1	Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit, nga ndonjë bankë e licencuar ose kompani e licencuar e sigurimeve.
Sigurimi i ofertës	5.2	Shuma e Sigurimit të Tenderit N/A
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	7.1	<i>Deri me dt. 12.08.2020</i>
Inspektimi i Aseteve	10.1	Do të bëhet më datën <b>10.08.2020</b> , prej orës 10.00-12.00.
Periudha vlefshmërisë së tenderit	13.1	Periudha e vlefshmërisë së ofertimit do të jetë <i>3- tre muaj</i> .
Mbyllja në zarf dhe Shënimi i Tenderëve	14.1	Përveç Tenderit origjinal, numri i kopjeve është <i>[një kopje]</i>
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	15.1	Afati i fundit për dorëzim është <i>data 17.07.2020, ora 10,00 në zyrën 603/A, Ish pallati i Rilindjës. kati VI.</i>
Hapja e Tenderit	17.1	Hapja e tenderit do të bëhet me datën <i>data 17.07.2020, ora 10,00 në zyrën 603/A, Ish pallati i Rilindjës. kati VI.</i>
Kriteret e Dhënies	21.1	<p><i>Dhënia e kontratës do të bazohet vetëm në çmim.</i></p> <p><b>Çmimi më i lartë</b></p> <p>Vlera fillestare do të jetë <b>1,000.00 euro</b></p> <p><b>Ne rastin e nënshkrimit të kontratës ofertuesi duhet të bëjë pagesën e qeras me parapagim 1 vjeçar;</b></p> <p><b>Kontrata është e vlefshme 15 vitë me mundësi vazhdimi.</b></p>

## **Aneks 1. Përshkrimi i Aseteve**

Ministria e Drejtësisë /Shërbimi Korrektues i Kosovës- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për dhënie me qira parcelën sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2) e cila gjendet në Vushtrri në Magjistralen Prishtinë Mitrovicë.

Përshkrimi i pronës të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Kjo pronë epet në qiradhënie në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç është dhe ku është" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e pronës. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e pronës .

### **Kriteret për pjesëmarrje në procedurën për aplikim janë:**

1. Parcela nuk mund të përdoret për ndërtime të larta (lejohet vetëm konstruksion metali);
2. Parcela nuk mund të përdoret për ushtrimin e veprimtarisë hoteliere apo lojëra te fatit;
3. Të interesuarit duhet të paraqesin planin lidhur me veprimtarin të cilën planifikojnë ta ushtrojnë;
4. Parcela do të ipet me qira sipas çmimit më të lart të ofruar nga ofertuesit;
5. Qiraja mujore për parcelën është minimum 1000 euro;
6. Me rastin e nënshkrimit të kontratës ofertuesi duhet të bëj pagesën e qeras me parapagim 1 vjeçar;
7. Kontrata duhet të noterizohet tek noteri i licencuar;
8. Pas përfundimit të kontratës parcela të kthehet në gjendjen të mëparshme apo sipas marrëveshjes mes palëve;
9. Periudha e kontratës së qirasë ipet në kohë zgjatje deri 15 vite;
10. Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk merr asnjë përgjegjësi lidhur me dokumentacionin dhe lejen për punë.

**Çmimi fillestar për qera është 1000 €/ për muaj**

Numri: SHKK-20-001-DHQ, Titulli: "Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)"



Numri: SHKK-20-001-DHQ, Titulli: "Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)"



DOSJA E TENDERIT PËR QERADHENIE  
15

## Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht seksionin 3 të Informacionit për Tenderuesit dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	



### Aneksi 3 SIGURIA E TENDERIT

Për: **emri i autoritetit kontraktues**  
Shërbimi Korrektues I Kosovës

(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: **[emri dhe adresa e operatorit ekonomik]**  
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli: "Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)"

Numri i referencës: SHKK-20-001-DHQ

#### Garancion me kërkesë të parë

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: **< shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra >** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
- b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
- c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
  - Të respektoj kushtet e kontratës; ose
  - Të bëjë pagesën.

Pagesa në shumën e limituar prej: **<shuma e garantuar>** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlen deri me: **<data dhe koha >**

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

\_\_\_\_\_  
Emri i institucionit financiar

\_\_\_\_\_  
Adresa

\_\_\_\_\_  
Data

## Aneksi 4 KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues:

Shërbimi Korrektues i Kosovës

*Ish pallati i Rilindjës. kati VI, zyra nr. 603/A.*

DUKE MARRË PARASYSH SE [emri i operatorit ekonomik] (më tej "Operatori Ekonomik"), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Referencës të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

*Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referimet në pjesën apo në pjesët e dosjes së tenderit:*

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identifikuar.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

**PJESA B: Draft KONTRATA<sup>1</sup> & KUSHTET E PËRGJITHSHME**

**PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA**

**Neni 1 Lënda Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)"**

KJO KONTRATË e lidhur më [vendos datën], në mes të: [shëno emrin e autoritetit kontraktues] këtu e tutje i referuar me "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë, dhe [shëno emrin e Blerësit], (këtu e tutje i referuar si "Blerësi"), në anën tjetër:

NDËRSA Autoriteti Kontraktues ka ftuar tenderët për shitje të aseteve, [shëno përshkrimin e aseteve] dhe ka pranuar Tenderin e dorëzuar nga Blerësi për blerjen e këtyre aseteve.

TANI KJO MARRËVESHTJE DËSHMON SI NË VIJIM:

1. Blerësi pajtohet të paguaj Autoritetin Kontraktues për marrjen e Asetit, Çmimin e Kontratës në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me Kontratë.
2. Duke konsideruar pagesat e kryera nga Blerësi, Autoriteti Kontraktues, siç theksohet në Kontratë, pajtohet të lëshoj Asetet në pajtim me dispozitat e kontratës.

**Neni 2 Lokacioni i Aseteve**

2.1 Lokacioni i aseteve është *Prishtinë*.

2.2 Zyrtari që duhet kontaktuar për aranzhimin e marrjes së aseteve është *[drejtoria e Shërbimeve publike]*

**Neni 3 Çmimi i kontratës**

3.1 Çmimi total do të jetë: [shëno çmimin në shifra] €; [shëno çmimin me fjalë] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër nuk është e vetmja pagesë që Blerësi i ka borxh Autoritetit Kontraktues sipas kontratës. Blerësi-qiramarrësi do të paguaj edhe një tarifë të caktuar në Rregulloren Komunale përkatëse dhe kjo pagesë nuk do të ndryshojë në kohëzgjatjen e kontratës.

3.3 Çmimi do të jetë përfundimtar dhe nuk do të ndryshohet.

3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme të kontratës.

**Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (c) Përshkrimi i Aseteve;
- (d) Tenderi i Blerësit.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

---

<sup>1</sup> Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

## Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Blerësit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhet me shkrim. Komunikimet do të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe<sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Blerësin.

Për Autoritetin Kontraktues:

<b>Emri:</b>	Nehat Thaçi
<b>Pozita:</b>	Zyrtari Kryesorë Administrativ
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	
<b>Vula:</b>	

Për Blerësin

<b>Emri:</b>	
<b>Pozita:</b>	
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	
<b>Vula:</b>	

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

## **PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Përkufizimet**

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Blerësit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Asetet**" në lidhje me këtë kontratë përkufizohen në Përshkrimin e Aseteve.

1.3 "**Autoriteti Kontraktues**" nënkupton autoritetin që shet Shërbimet, siç specifikohet në Fletën e të Dhënave të Tenderit

1.4 "**Blerësi**" do të thotë një person natyral ose ligjorë që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate bënë blerjen e asetëve të cilat janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "**Palë**" nënkupton palët që nënshkruajnë kontratën.

1.6 "**Çmimi i kontratës**" do të thotë shuma që do ti paguhet autoriteti kontraktues sipas specifikimit në formën e kontratës.

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha**

2.1 Ligjet e Kosovës në fuqi do të aplikohen në të gjitha çështjet që nuk mbulohen me dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata relevante në Prishtinë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet me shkrim në mes të palëve do të hartohen në gjuhën e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

### **Neni 3 Gjendja e Aseteve**

3.1 Autoriteti Kontraktues do të jep me qera lokacionet "të gjendjes aktuale, dhe lokacionit aktual" dhe nuk do të ofroj asnjë garanci apo Garancion në lidhje me gjendjen e lokacioneve.

3.2 Blerësi do të mbaj përgjegjësinë e plotë për asetet nga data dhe koha e transferim dhe do të ketë përsipër të gjitha kostot dhe rreziqet në lidhje me banesat në vazhdimësi.

### **Neni 4 Parimet e përgjithshme të pagesës**

4.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

4.2 Blerësi do të bëjë pagesën për Autoritetin Kontraktues në shumën e plotë të Kontratës, siç është përkufizuar në formën e kontratës, brenda dy javë nga data e kontratës. Pagesa për shfrytëzim bëhet në çdo muaj më saktësishtë brenda javës së parë të muajit vijues . Autoriteti kontraktues do të lëshojë një fletëpranim si dëshmi të pagesës.

4.3 Pagesa do të bëhet në llogarinë bankare të Autoritetit Kontraktues me nr. **1000400070003769** në BQK, të cekur në Seksionin III dhe do të konsiderohet si pagesë në datën kur kreditohet në llogarinë e Autoritetit Kontraktues.

4.4 Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë këtë kontratë nëse Blerësi ka dështuar të paguaj Çmimin e Plotë të Kontratës brenda një jave nga afati i fundit për pagesë.

### **5. Transferi i Aseteve dhe kthimi i tyre**

5.1 Lokacioni i banesave është i specifikuar në Formën e Kontratës.

5.2 Blerësi do të ketë përgjegjësi të plotë dhe do të bartë të gjitha rreziqet dhe kostot lidhur me marrjen me qera të banesave nga lokacioni i përcaktuar më lartë dhe do të bartë dhe paguaj të gjitha kostot e asociuara.

5.3 Blerësi do të marrë banesën në shfrytëzim brenda një jave nga data kur Autoriteti Kontraktues pranon pagesën për banesa.

5.4 Blerësi do të kontaktoj zyrtarin e emëruar në Formën e Kontratës, në adresën e autoritetit kontraktues, siç specifikohet në formën e kontratës, për të aranzhuar datën dhe kohën për marrjen e banesave.

5.5 Blerësi do të nënshkruaj një Certifikatë të Dorëzimit, që certifikon pranimin e aseteve, në kohën e transferit.

5.6.Kjo kontratë vlen në kohëzgjatje prej një viti me mundësi vazhdimi. Me pajtimin e palëve dhe nëse legjislati i aplikueshëm në 6 muajt e fundit para skadimit të kontratës e lejon një gjë e tillë, atëherë mund të vazhdohet kjo kontratë por jo më shumë se sa periudha fillestare e kontraktuar dhe jo me kushte financiare më të ulëta se në këtë kontratë.

5.7.Me rastin e skadimit të kontratës OE ose personi fizik duhet që lokacionin ta kthej në gjendjen e mëparshme. Dy palët do të bëjnë një raport përfundimtarë të përmbylljes së obligimeve të ndërsellta financiare dhe të dorëzimit të lokacioneve në gjendjen e mëparshme.

#### **Neni 6 Forca madhore**

6.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

6.2 Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

6.3 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

6.4 Nëse Blerësi kërkon shpenzime shtesë për respektimin e udhëzimeve të Autoritetit Kontraktues ose përdorimin e mënyrave alternative nën Nenin 6.3, shumata e tillë duhet të certifikohet nga Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 7 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

7.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

7.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit [*Specifikoni Komisionin departamentin përgjegjës për pajtim*]. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

8.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose një vendim nga *gjykata kompetente* në pajtim me Ligjin e Kosovës; ose

b) kur palët pajtohen, një vendim arbitrimin. Arbitrimi i [*specifiko organin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes*] në pajtim me [*specifiko rregullat e arbitrimit (rregullat e Odës Ndërkombëtare të Biznesit, Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin Ndërkombëtarë të Tregtisë, ose procedurë tjetër të arbitrimit të njohur ndërkombëtarisht)*]

8.2 Modeli i zgjidhjes së mosmarrëveshjes p.sh. gjykata apo arbitrim do të vendoset nga palët para nënshkrimit të kontratës

**PJESA III E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR**

<b>MBAJTËSI I LLOGARISË</b>	
<b>Emri</b>	
<b>Adresa</b>	
<b>Qyteti</b>	
<b>Kodi Postar</b>	
<b>Kontakti</b>	
<b>Telefoni</b>	
<b>E-mail</b>	
<b>Numri i TVSH</b>	

<b>BANKA</b>	
<b>Emri</b>	
<b>Adresa</b>	
<b>Qyteti</b>	
<b>Kodi Postar</b>	
<b>Shteti</b>	
<b>Llogaria Bankare</b>	
<b>IBAN (opsionale)</b>	
<b>BIC (Opsionale)</b>	

**SHËNIME:**

<b><u>VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (të dyja të obligueshme)</u></b>
---

<b><u>DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)</u></b>
---

**PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT**

**Seksioni I. Formulari i Tenderit**

**Për:** Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

**Titulli i kontratës:** *Dhënia me qira e parcelës sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2)*

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjen e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: [SH.K.-20-001-DHQ]. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të marrim me qera lokacionet, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

3. Çmimi total i tenderit është:

Çmimi i qirasë \_\_\_\_\_ € [shëno çmimin e tenderit për pjesën e I-rë, në shifra Dhe me fjalë]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej [60 ditëve] nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Ne konfirmojmë që çmimet e kuotuar në Listën e Aseteve dhe Listën e Çmimeve janë fikse për periudhën e vlefshmërisë dhe nuk do të mund të ndryshohen ose rishqyrtohen.

6. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë

E DORËZUAR NGA IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	
ADRESA E PLOTE	
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI	
POZITA	
NËNSHKRIMI	
DATA	
VULA	



## Seksioni II. Lista e Aseteve dhe Përshkrimi i Çmimeve

### PJESA I

Nr.	Përshkrimi	Çmimi minimal i qerasë	Çmimi i dhënë ofertës
1.	Ministria e Drejtësisë/Shërbimi Korrektues si posedues të pronës/parcelës me Numër të njësisë sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me Nr. UL-70202016-05107 lëshuar me datë 12/20/2011 nga Komuna e Vushtrrisë.	1000,00 €	

Parcela e lartëcekur gjendet në Magjistralen Prishtinë Mitrovicë

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	
NËNSHKRIMI:	
DATA:	
VULA:	